# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 | 07/05/2024 | Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetar:<br><br>1. Kopje të shkresave nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht shkresat që kanë ardhur nga Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve për planet e mbarështhrimit të dërguara tek ju, si edhe përgjigjet tuaja për secilën shkresë.<br><br>2. Referuar po të njëjtit email ju shpreheni se ALFIS është jashtë funksionit. Atëhere si është marrë në dorëzim një projekt i cili do të duhej të funksiononte?<br><br>3. A janë miratuar nga ju planet e mbarështrimit të Bashkive Berat, Gramsh, Korçë, Maliq, Has dhe Malësi e Madhe? Kërkojmë një kopje të përgjigjes tuaj mbi këto plane. | 15/05/2024 | 1.Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 40 prot, të datës 07.05.2024 ku na kërkoni "Kopje të shkresave nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, konkretisht shkresat që kanë ardhur nga Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve për planet e mbarështrimit të dërguara tek ju, si edhe përgjigjet tuaja për secilën shkresë" ju bëjmë me dije se:<br><br>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije se edhe mbas insistimit ton pr t'na i dërguar Planet për vlerësim n rrugë shkresore-zyrtare gjë që nuk është bërë deri tani.<br>Nga ana e MTM-së na dërgohen materialet nprmjet sistemit dhe mbas shqyrtimit, ne japim vlerësimet tona teknike kur na është kërkuar nëpërmjet email-it zyrtar.<br>Në rastet kur kjo është e pamundur kemi organizuar takime të përbashkëta ku janë analizuar dokumentat e paraqitura dhe jan dhënë | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mendimet teknike. Materialet i disponon MTM si organi që i miraton në bazë të ligjit.<br><br>2.Në përgjigje të pyetjes tuaj: “Referuar po të njëjtit email ju shpreheni se ALFIS është jashtë funksionit. Atëherë si është marrë në dorëzim një projekt i cili do të duhej të funksiononte?” ju sqarojmë se jemi shprehur konkretisht:<br><br>“Këto shërbime nuk mund të ofrohen në këtë fazë që ALFIS është i paaksesueshëm, përdorimi zyrtar i tij nuk mund të arrihet pa mbështetjen e mirëmbajtjes nga A.K.SH.I”, që do të thotë se ALFIS është i paaksesueshëm për shkak të mungesës së proceduarave që duhet të ndiqen nga A.K.SH.I. Përdorimi zyrtar i tij ka protokolle dhe procedura te caktuara. Ne nuk kemi në stafin tonë një I.T për t’ju dhënë shpjegime teknike të fushës.<br><br>Sistemi është funksional në vetvete mbasi ne e kemi testuar dhe vlerësuar, por kjo nuk ka lidhje me mbështetjet për mirëmbajtje, përmirësim etj.<br><br>3.Në përgjigje të pyetjes tuaj: “A janë miratuar nga ju planet e mbarështrimit të Bashkive Berat, Gramsh, Korçë, Maliq, Has dhe Malësi e Madhe? Kërkojmë një kopje të përgjigjes tuaj mbi këto plane.” Ju bëjmë me dije se:<br><br>Ne nuk miratojmë Plane Mbarështimi sipas nenit 11 te ligjit 57/2020 “Për Pyjet” , P.M miratohen nga Ministri. Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit që shoqëron një Plan Mbarështimi, nga ana e M.T.M-së na dërgohen materialet nëpërmjet sistemit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe nëpërmjet emailit zyrtar, ne japim vlerësimet tona teknike kur na është kërkuar.<br><br>Në rastet kur kjo është e pamundur, ne kemi organizuar takime të përbashkëta ku janë analizuar dokumentat e paraqitura dhe jane dhënë mendimet teknike. Materialet i disponon M.T.M, si Organi që i miraton në bazë të ligjit. | | |